

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

60H-1  
P 33

Maro Pasho

**PARA  
MONUMENTIT  
poezi**



SJH-1  
P33

# MARO PASHO

## PARA MONUMENTIT

Poezi



SHTEPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Tirazhi 1500 kopje      Format 70x100 /32      Stash: 2204-72

---

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re  
Tiranë, 1979

## ZEMRA E KOMANDANTIT

*Njoha një ish-komandant partizan, të cilat që nga koha e luftës, pranë zemrës i ka mbetur një copë predhe.*

Afër zemrës të shpoi predha  
edhe mbeti aty brenda...  
Po ti prive batalionin,  
maleve buçiti kënga!

Tridhjet' vjet aty ka predha,  
komandant, dhe të kujton  
se armiku jetën tënde  
prapë e do dhe e kërkon.

Kur përreth fryjnë tufanet  
edhe nata krahët ndër,  
predha prapë ta shpon ty zemrën,  
plaga prapë ty të ther.

Edhe vrenjtesh, komandant,  
plaga të shtrëngon si darë,  
po vështrimi nuk të erret,  
ai mbetet prapë i larë.

Afër zemrës të shpoi predha,  
po ti thirre: «Para, shokë!»  
Komandant i batalionit,  
lis me rrënjet thellë në tokë.

## B O D R U M Ç J A<sup>1)</sup>

Burgu lagësht nën kala,  
në të ftohtën tokë të zezë.  
Muret ngrihen sa tre male,  
në qelira ndrydhen shpresa....

Dhe komitët ndër zinxhira  
shohin se si shkasin retë;  
qiellit, larg vështrimin hedhin,  
ku shqiponjat kanë foletë.

Heqin zvarrë këmbët e rënda  
në oborrin e rrëthuar:  
«Hej, ti hekur anadolli,  
se sa fort na ke shtrënguar!»

---

1) Vallja «Bodrumçe» kërcehej nga komitët në burg në kalanë e Gjirokastrës, me këmbë të lidhura me zinxhirë.

Po komitët mblidhen tok,  
ngjeshur supet mirë e mirë,  
për çudi po hedhin valle,  
lidhur këmbët me zinxhirë.

Valle labe ndër zinxhira,  
herë fuqishëm, herë ngadalë.  
Oh, sa ëndrra dhe dëshira  
pleksen tok në këtë valle!

Dhe përhapej vallja labe,  
kënga labe që ndez zemrat,  
nëpër popull ajo rritej,  
ngjallte shpresat, ngjallte ëndrrat.

## KOMANDANTI PARTIZAN

*Kushtuar S. S.*

Më mbetën sytë në një fletë.  
Kjo skicë ç'është?

Andej janë forcat e armikut  
ne urën mbrojmë këtu,  
ja dy viza paralele,  
që zgjaten tej me laps blu.

C'ke dashur të thuash?  
Këtë plan ku e skicove?

Ku e mbështete këtë bllok,  
kur kompaninë gjermane e groposët?

Me këtë plan sulmove kodrën  
dhe urën mbrojte,  
komandant!

Mbi këtë plan  
me laps një kryq  
mund të vinte  
akademiku gjerman!

Por në beteja  
kryqin ia vure ti,  
o komandanti partizan!

## ATENTATORIT TË PERANDORIT

Agimi i një dite maji  
lëkundte një litar,  
në mes t'oborrit trekëmbshi,  
diku u hap një varr.

Ja OVRA<sup>1)</sup> shpejt procesin çeli;  
qëlluan Viktor Emanuelin.

Në mes milicisë shkon Vasili  
i qetë, kryelartë.  
Pas hekurash këndoijnë shokët  
një këngë të re, të zjarrtë.

---

1) OVRA — policia e fshehtë fashiste.

Një krehër trimi ç'po kërkon,  
të krehë flokët e zes.

«Ai që për Atdhenë bie,  
i bukur le të mbesë».

Dhe majet derdhin trëndafilë  
çdo vit, mbi ty, Vasil!

7 PRILL 1939

Qielli rrëzonte retë,  
shtynte njërën pas tjetrës  
pelerina të errëta,  
si guna të dhirta,  
të mblidhnin supet  
e zhveshura,  
të mardhura  
të maleve...

Nga avionët fashistë  
trakte «miqësie»  
villeshin atë mëngjes,  
si re të zeza  
donin të mbulonin shpirtin e popullit tim...

Por në Durrës,  
Vlorë,  
Shëngjin

krisi pushka e vegjëlisë,  
që ngrinte kushtrimin  
gjer lart përmbi re:  
«Zot në këtë truall,  
jemi ne».

## NË MAJË TË MALIT

Në majë të malit çobanët  
një kil<sup>1)</sup> po e pjekin në zjarr,  
ra nata e errët nga stanet  
një këngë përhapet dalngadalë.

Sinjali i Radio Tiranës  
në mes këtë këngë e pret,  
sjell valë gjer lart përmbi stanet,  
Enveri i dashur po flet.

Çobanët të mbledhur rrëth zjarrit  
Enverin e patën aty,  
me fjalë të shtrenjta, të qarta,  
të thjeshtëve u foli Ai.

---

1) kil — kulaç i pjekur në hi.

## PARA MONUMENTIT, NË SHESHIN E FLAMURIT

Hapi yt i lehtë hynte salloneve  
tokën duke rrahur nëpër Evropë.  
Dhe kérkoje ti atë të drejtë,  
që e meritonim më shumë se kushdo në botë!

Po diplomacia mbyllej në një çels  
edhe dyert hapeshin në një sustë,  
ti me bastunin tënd trokisje qetë  
si ai që i thotë qenit «sus»!

Turbullirave të kohërave kérkoje,  
porsi Arkimedi, pikën për mbështetje,  
atë pikë ti vetë do ta gjeje,  
zemrën popullit me dorë, kur t'ia prekje.

Nëpër letrat sekrete të sulltanit  
emri yt po mbyllej në kuti,  
ti në zemrën tënde kishe mbyllur  
ëndrrën e madhe për liri.

Para monumentit tënd po qëndroj,  
kohërat të sollën gjer tek ne,  
ma jep dorën, Plak i nderuar, të ta puth  
jam një filizë e kohës sonë të re.

## 5 MAJI

Fryu era e majit,  
mblodhi nga kopshtet trëndafilat  
dhe i vuri mbi varret e të vrarëve.  
Dhe ranë trëndafilat, ranë,  
mbi tokën mëmë,  
sikur i zuri gjumi i pafund...


Dhe duket se gishtat kanë zgjatur të rënët  
të mbajnë fort këto buqeta,  
buzëqeshjen e kopshteve tonë,  
aromën e fushave të blerta!

## NË VARREZAT E DËSHMORËVE

Këtu përmbi kodër  
lart ju ngjitëm ne:  
«Lule, more trima,  
që ratë për Atdhe»!

Ja, sot përmbi ju  
lule edhe këngë  
mbi ballin e pastër  
seç hodhi ky vend!

Ju zbritët nga malet  
me lirinë në ballë.  
C'është për ju një lule,  
c'është një këngë, vallë?



Kokën jua përzhitë  
flaka e barotit,  
duart jua këputi  
predhë e fortë e topit.

Këmbët në dëborë  
kallkan seç ju ngrinë,  
kur me këngë lufte  
shuanit urinë.

Nëpër suferina  
çanit ju rrëthimet,  
netëve të errta  
hidhnit vetëtima.

Mbi kryqin e fricit  
ngritet bajonetën,  
gjoksi juaj mbushej  
me këngët për jetën.

Këtu te kjo kodër  
lule sollëm ne....  
Të këndojmë për trimat,  
që ranë për Atdhe.

## NJË DEGË NGA VRESHTAT ME ULLINJ

*Të mbeturve në kampet naziste  
të përqëndrimit.*

Në dhe të huaj kockat ju mbetën  
krematoriumeve naziste,  
kur Shqipërinë buzëdeti  
printe në luftë Partia Komuniste!

Kalonin vjetët, rënkonin kockat.  
(Në dhen e huaj s'ka qetësi).  
Ku ishin nënrat, ku ishin motrat,  
t'ju mblidhnin eshtrat në shami!

Ju s'kishit varr që t'ju mbillnim  
mbi kokat tuaja nga një ulli  
e për çdo maj lule të hidhnik  
sipas zakonit në Shqipëri.

Ndaj sollëm ne aq larg tek ju,  
nga malet tonia mermerin gri,  
një copë qiell nga qielli blu,  
një degë nga vreshtat me ulli.

## TE URA NË DRASHOVICË

Gjëmuan sërishmi  
pushkët me gjalm të njëzetës.  
Heroizmi thërret heroizmin!  
Tek Ura e Drashovicës  
u pleksën krismat  
nën yjet e kuq të partizanëve,  
për të ndriçuar një epope të re.

## BIJË, MOJ MALI!\*)

...Tek shkoje në rrugën tënde,  
mercenari, qën i qënit,  
të tha ndal e ti nuk ndënje...

Popullore

Seç gjëmon ky Joni,  
frym e shfrym tallaz,  
Ku shkon, Amali?  
Ty të ndjekin pas.

Malet janë të lartë,  
harcat janë të mprehta;  
ku ngjitesh, çobankë,  
hedhur pas gërshetat?

Dhëntë blegërijnë,  
të kërkojnë, Mali,  
shkrepat ulërijnë,  
Bijë, moj Mali!

— Shkoj në rrugën time,  
malet më thërrasin,  
tek ndrijnë vetëtimat,  
ku këngët buçasin.

Tek lufta e rreptë,  
ku po ndizen yjet,  
bukë duan djemtë,  
pushkë e fishekë! —

Të thërrasin «ndal»,  
është një qen i qenit.  
Nisu, Amali,  
shko në rrugën tënde.

Pas godet tradhtia,  
qeni mercenar,  
Ngrihet Amalia  
lapidar i bardhë.

Dhe kënga ç'u ndez,  
nder dhe trimëri,  
vajzë shqiptare,  
bijë, moj Mali!

---

\*) Kjo poezi i kushtohët dëshmores Mali Kozma Andoni (Pipa) nga fshati Vuno i Vlorës, e cila në mars të vitit 1943, ndërsa shkonte për të kryer detyrën e ngarkuar nga Partia, ra si trimëreshë nga plumbat e fashistëve dhe tradhëtarëve.

## NATË NË LLOGORA...

Natë,  
yjet një nga një  
u futën nën krahët e pishave  
dhe mbyllën qepallat  
me halat e mprehta,  
të gjelbra.  
Deti  
në valë  
ju këndon ninananën.  
Natën e mirë!

## E DI TI GJUHËN E VALËVE?

E di ti gjuhën e valëve?  
E njeh ti murmuritjen e stërkalave?  
E kupton ti zhurmën e rërës  
nën katër këpucë?  
Po kuvertën e natës  
qëndisur me piña yjesh,  
si sytë e dashurisë,  
që mbështjell supet tanë të brishtë  
e ke parë vallë?  
Jo, ti njeri i vogël,  
natyrisht, nuk i njeh këto,  
ndaj zvarrë hiqesh  
pas gjurmëve tona  
që nesër të na buzëqeshësh  
me shpoti...

## KËTË NATË

Limonat zbërthyen gjirin e bardhë  
dhe bregun me aromë e spërkatën,  
më duket se yjet me dorë po i kap,  
t'i qep mbi mantelin ngjyrë vjollcë të natës.

Të heshtur ne ecim, për ne flet deti,  
fëshfërima e portokajve të gjelbër nga larg.  
Në zemër melodia e valëve më mbeti  
si tingujt eëmbël që shpërndan ti me hark.

Më ranë përmbi flokë kaq shumë xixëllonja,  
ndriçimin e yjeve sonte kanë marrë...  
Oh, këtë natë, këtë natë do të doja,  
me dorë ta skalitja në zajet e bardhë.

## S'KA NETË TË QETA...

Nuk ka më netë të qeta  
në fshat,  
ka kohë qetësia është prishur!  
Hëna, ndoshta, trishtohet atje lart  
se kënga e bilbilave kokëkrisur,  
u mbulua nga zhurma e traktorit,  
ndërsa këngë të reja këndon,  
kur ëmbël rrjedh nëpër gurë  
ujët e Izvorit.

## QE TE NDRIJNË KËTA YJE

Që të ndrijnë këta yj, i dashur,  
mbi gëzimin tonë këtë natë,  
duhej mijëra yje të na binin,  
aq të kuq, aq të zjarrtë.

## P R A N V E R È

Puhiza fishkelleu lehtë,  
si djalë çapkën pas gardhit,  
dhe bajamja,  
ngarkuar me dashuri pranverore,  
u drodh,  
shpalosi mbulesën e qëndisur  
dhe lëshoi qindra petale,  
si buzëqeshje të bardha vajzash,  
që po kthehen nga ara  
në këtë muzg të hareshëm.

## GJYSHI YT I BINTE CYLES

*Nipit të rapsodit lab*

Gjyshi yt i binte cylës,  
tek rreh këmba e sorkadhit,  
gjyshi yt i binte fyellit,  
tek veron thëllënxit' e malit.

Gjyshi yt i bij trumbetës,  
kur kërkonte shpagë Shqipëria,  
xha Selimi ngrinte bejte,  
ku këndohej trimëria.

Ti nga skena me violinë  
derdh petale luleshqere,  
nëpër gishtat aq të njomë  
seç po fryn një fllad pranvere.

Heshtur salsa po dëgjon,  
tingujt që zbritën nga mali,  
xha Selimin tek këndon:  
«Qasi, shokë, të ma mbani».

## MË MBETI NË BUZË

Më mbeti në buzë  
gazi i një mbrëmjeje,  
më mbeti në shpirt  
një dhembje e ëmbël,  
më mbeti tingulli  
i të qeshurit tënd  
si lajtmotiv në vargjet e mia...

## NË ISH-SPITALIN PARTIZAN

Çdo gjë ka heshtur  
në këtë shpellë...  
As plagë më,  
asnjë rënkim  
dhe gjaku i kuq,  
që dikur rrodhi  
nga sharr' e drurit  
në thëllim,  
tek shtrat' i gurtë  
dëshmi ka ngrirë.

Po hyj ngadalë  
në këtë shpellë.  
Ju flini, shokë partizanë!  
Unë gjumin tuaj nuk e prish,  
unë gjumit tuaj i bëj roje  
me ditë e netë  
në përgjim...

Ju dhëmbin plagët?  
Këtu jam  
në krahë kam çantën  
plot me barna.  
Djersën e ballit do t'jua fshij  
me shalln' e bukur të aksionit  
dhe etjen tuaj do ta shuaj  
me ujë nga çezm' e re e fshatit.

Ju keni ftohtë?  
Ju ngroh unë  
me frymën time,  
me zjarrin tim.  
Nuk ju zë gjumi?  
Do t'ju këndoja këngën e moçme  
të trimit,  
që mposhti plagët e balozit...

Dhe dal ngadalë nga kjo shpellë,  
dikur spital partizan,  
dhe marr me vete  
këngën tuaj,  
që thellë buçiti  
nga gjoksi i shpellës...  
Po dal ngadalë  
mos t'ju prish gjumin,  
unë roje e gjumit tuaj mbetem....

## Ç'MË THA KËNGËTARJA POPULLORE NGA PILURI

Mund të shkrinte bora  
përmbi degët e pishave,  
mund të çelnin vjollcat  
mes ferrash,  
mund të ndalonin varkat në breg,  
po të këndonte  
nëna ime.

Por nëna ime ndrydhte zërin  
brenda vetvetes,  
me pllakën e rëndë të zisë.  
Ç'duar do ta lëviznin vallë  
atë pllakë zije,  
që i merrete frymën?!

Vetëm në vaki  
ndihej zëri i nënës.  
Kur qante ajo

heshtte dhoma e tärë  
dhe dëgjonte  
si dridheshin ligjet në gojën e saj!  
Eh, ligjet, ligjet e nënave tonë!

Nëna ime kishte zë të bukur,  
nëna ime kishte zë të ëmbël...

Por

nëna ime nuk këndoi kurrë!

Zëri i saj buçet tanë  
nëpërmjet zërit tim.

Kur dal në skenë  
këndoja dhe për nënën  
këngët, që gjithë jetën i ëndërroi,  
këngët, që kurrë s'i këndoi...

## MBRËMË GJITONI . . .

Mbrëmë gjitoni ynë kishte dasmë  
dhe gjer vonë gërneta nuk pushoi.  
U ankuan gurët e sokakut,  
jelekverdha veshur nuk mungoi...

Dhe ai që këngën merr i pari,  
gjysmë mbylli sytë e larg vështroi:  
«Dalngadalë, — tha, — po vjen behari»  
tavolina befas seç gjëmoi.

Lefi dhe Mitati<sup>1)</sup> vijnë në dasma,  
përshëndesin, zemra ka mall,  
si dhëndurë të hershëm të lirisë  
dhe largohen prapë dalngadalë...

---

1) Lef Sallata dhe Mitat Dauti — dëshmorë të Luftës për liri.

## V A J K U R B E T I

— *Motiv populor* —

Mbiu nerënxa në breg,  
lëshoi degët përmbi det,  
ndoshta vala do t'ia çojë  
një gjeth burrit në kurbet...

Dhe t'i thotë ajo fletë  
brengat e zemrës së shkretë.  
Erë e tokës mëmë ta zgjojë.  
Iku, u harrua një jetë!

Deti paska tramundanë,  
vend' i shkretë anembanë.  
Zjarri ty, o Amerikë,  
frungull, o Arabistan!

C'më vajton aty në breg,  
tek vjen vala edhe shket?  
O nerënëxë, lotët e tua  
mijëra fjalë që dot s'i flet.

Deti paska shumë tallaz,  
zemra paska shumë maraz,  
o nerënëxë, buzë detit,  
plas, pse s'plas!

Mbiu nerënxa mbi breg,  
lëshoi degët përmbi det.  
O nerënëxë, kjo kripë e detit  
degët e njoma po t'i djeg.

## PËRMBI VALË E PËRMBI SHKUMË

Ta putha ballin me mendime.  
(Sa shumë mendime në atë ballë!...)  
Si det i qetëjeta ime,  
kurse jotja det me dallgë.

N'atë dallgë të jetës sate,  
një ditë hyra edhe unë,  
dhe mbështeta kokën bjonde  
përmbi valë e përmbi shkumë...

## M A L E T

Asnjëherë nuk i pashë  
malet kaq pranë,  
asnijëherë nuk i ndjeva  
malet kaq pranë.

Kokën mbështetur në male,  
këmbët në buzët e lumit,  
mbi kokë fryjnë erëra të forta,  
te këmbët murmurijnë valët...

## KËNGA E MARINARËVE TANË LARG ATDHEUT

Ne çajmë dallgë në oqean,  
të huaja porte dhe qytete,  
po zemrën tonë një mall e mban,  
mall' i Atdheut, sa dhjetë dete!

Ka dete gri në kontinente,  
ka dallgë shumë e tramundanë,  
ne kaltërsinë marrim me vete  
nga brigjet tanë që pas i lamë.

Dhe nisim tok të këndojmë  
një këngë nënës, një këngë sykaltrës,  
dete të huaj, porte të ftohtë,  
ne na mban ngrohtë hiri i vatrës.

Anija jonë shpalos flamurin,  
që e përflakëm ndër beteja.  
Nga larg Atdheu na përshëndet,  
çdo ditë fitore gjithmonë të reja!

## KËNGA E VJELËSES SË RRUSHIT

Frym kjo erë e detit  
vreshtave ngarkuar  
dhe shamit' e bardha  
tund e përmalluar.

Mbushen koshat plot,  
një këngë vjen ngadalë,  
ëmbëlsi e mushtit  
derdhur në dy fjalë.

Derdhur në dy fjalë,  
shkrirë në një vështrim,  
shkojnë e vijnë valë  
përmbi gjoksin tim.

Veriget e rrushit  
posi këngë e ngjeshur,  
sec më ndrin mes gjethesh  
syri yt i qeshur.

Fryu kjo erë e detit,  
më hodhi shaminë...  
Vreshta e ngarkuar  
diç po fëshfërin.

## N E Ç A D R A

Mbi çadra  
kemi hedhur plastmas,  
shiu troket  
në mijëra gishtërinj,  
tik-tak, tik-tak.

Pikat rrjedhin  
nëpër mushama.  
Duket  
se janë këputur  
gjerdanët e reve,  
e bien margaritarë  
nga gusha e qiellit!

## PASQYRA E LËNDËS

Zemra e komandantit .....	3
Bodrumçja .....	5
Komandanti partizan .....	7
Atentatorit të perandorit .....	9
7 prill 1939 .....	11
Në majë të malit .....	13
Para monumentit, në sheshin e flamurit .....	14
5 Maji .....	16
Në varrezat e dëshmorëve .....	17
Një degë nga vreshtat me ullinj .....	19
Te Ura në Drashovicë .....	21
Bijë, mój Mali! .....	22
Natë në Llogora... .....	24
E di ti gjuhën e valëve? .....	25
Këtë natë .....	26
S'ka netë të qeta... .....	27
Që të ndrijnë këta yje .....	28
Pranverë .....	29
Gjyshi yt i binte cyles .....	30
Më mbeti në buzë .....	32
Në ish-spitalin partizan .....	33
C'më tha këngëtarja popullore nga Piluri .....	35
Mbrëmë gjitoni .....	37

Vaj kurbeti .....	38
Përmbi valë e përmbi shkumë .....	40
Malet .....	41
Kënga e marinareve tanë larg Atdheut .....	42
Kënga e vjelëses së rrushit .....	44
Në çadra .....	46